



REPUBLIKA E KOSOVES/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICE/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria e Arsimit
Nr.prot/ 285
Data:16.06.2023

Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me Institucionin Parashkollor “Ganimete Tërbeshi” bazuar, në nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Udhëzimin Administrativ Nr.03/2022 Për përfshirjen e fëmijëve në Institucionet Parashkollore në Kosovë, shpall:

K O N K U R S

PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE NË INSTITUCIONIN PARASHKOLLOR “GANIMETE TËRBESHI”
GJAKOVË, PËR VITIN SHKOLLOR 2023/2024

Për: Institucionin Parashkollor “Ganimete Tërbeshi”

Përmes: Drejtorisë së Arsimit – Komuna e Gjakovës

Të nderuar qytetarë të komunës së Gjakovës!

Drejtoria e Arsimit në koordinim me Institucionin Parashkollor “Ganimete Tërbeshi” Gjakovë, ju njoftojmë që është hapur konkursi për plotësimin e vendeve të cilat lirohen në grupet edukative për vitin shkollor 2023/24.

Në Institucionin Parashkollor “Ganimete Tërbeshi” për vitin shkollor 2023/2024, do të pranohen fëmijë nga mosha 9 (muaj) deri në 4 (veç).

Në Institucionin Parashkollor “Ganimete Tërbeshi” për vitin shkollor 2023/2024, janë të lira 160 vende për fëmijët e moshës nga 9 (muaj) deri në 4 (vjeç), në të gjitha objektet e Institucionit.

Konkursi shpallet me këto kushte dhe kritere:

1. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Prindi/kujdestari ligjor i cili planifikon të regjistroj fëmijën duhet të paraqesin këto dokumente:

- Ekstraktin e lindjes së fëmijës,
- Faturë të shërbimeve komunale (jo më e vjetër se 6 muaj)
- Dëshmi nga mjeku për gjendjen e përgjithshme shëndetësorë
- Dëshmi për vaksinimin e fëmijës (fletorja e shëndetit të fëmijës kopje)
- Dëshmi për marrëdhënie pune për prindërit/kujdestarin ligjor
- Pasqyra e trustit për 6 mujorin e fundit e prindërve/kujdestarit ligjor.

2. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për aplikimi bëhet në Institucionin Parashkollor “ Ganimete Tërbeshi” në objektin ku gjendet administrata nga data 19.06.2023 deri 03.07.2023, nga ora 8:00 deri në ora 16:00 brenda orarit zyrtar të punës (Objekti Nr.4, Orize).

3. Nuk do të mirren parasysh aplikimet e bëra para datës së shpalljes të këtij konkursi.

Sqarim: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Drejtör i Drejtorisë së Arsimit

Eranda Baçi

